

Dalës-Izleazna

Nr. IV-223
Br.


Data 19.11.2018
Datum

OBILIQ-OBILIQ

Republika e Kosovës
Republika Kosovo- Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government

Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obiliq

Data	19.11.2018
Për;	Kryesusi i Kuvendit Komunal - Z. Burim Gerguri
Përmes	
Nga	Drejtorija e Ekonomis dhe Financave -Z.Zarife Behluli
Lënda	Kërkesë për aprovimin e Vendimit për Tatimin në Pronë



I nderuar

Duke pasur parasysh se me shfuqizimin e Ligjin Nr ;03/L-204 dhe hyrjen ne fuqi te Ligjit te ri te Tatimit- Ligjit Nr 06/L-005 per Tatimin ne Pronen e Paluajtshme i cili eshte ne fuqi qe nga dt;01.Tetor 2018 Kuvendi Komunal bazuar në Ligjin Nr. 06/L-005, për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, neni 9, paragrafi 1, nën paragrafët 1.1 deri 1.9, cakton normat tatimore për vitin 2019 për të gjitha kategoritë e pronave, me përjashtim të kategorisë pronë publike.

Me rekomandim të Drejtorit të Departamentit të Tatimit në Pronë z.Shkelzen Morina te dates 24.10.2018 komunat nuk mund ti ndryshojnë zonat e vlerësimit dhe nivelet e vlerave për asnjë kategori të objekteve për vitin tatimor 2019.

Andaj kerkojme qe per vitin 2019 te behet vetem konfirmimi i njejte i bazes Tatimore dhe Ndarjes Zonale sipas Rregullores Nr. I - 75 e datë 18.09.2017 per Tatimin mbi Pronen e Paluajtshme per vitin 2018 .

Ndersa qe nga viti I ardheshem Baza Tatimore dhe Ndarja Zonale do te jete kompetence e MF- Departamentit te Tatimit ne Prone sipas Ligjit te ri te tatimit Ligjit Nr. 06/L-005.

Nga krejt kjo dhe nga konfirmimi I marre nga Departamenti I Tatimit ne Prone kerkojme qe keto qeshtje te rregullohen me nxjerrjen e nje Vendimi nga ana e Kuvendit Komunal .

Me respekt

Neni 4
Iftiza në fuqi

Ky vendim hyr në fuqi 7 ditë pas publikimit në Wsh (www.zyrtar.com) të Komunitetit dhe do të llogaritet si datuar nga 1 janar 2019.

Vendimi Nr.

••

Kryesuesi i Kuvendit
Burim Gerguri



Në mbështetje të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale dhe të Ligjit Nr 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme dhe Nenit 83 pika 19 të Statutit të Kuvendit Komunal të Obiliqit Nr; I -34 të datë 25.04.2016 Drejtoria për Buxhet dhe Financa e Komunes së Obiliqit propozon këtë:

PROPOZIM - VENDIM
MBI TATIMIN E PRONËS SË PALUAJTSHME PËR VITIN 2019

Neni 1
Normat Tatimore

Në zbatim të Ligjit Nr. 06/L-005, për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, neni 9, paragrafi 1, nën paragrafët 1.1 deri 1.9, Kuvendi Komunal i Komunës së Obiliqit cakton normat tatimore për vitin 2019 për të gjitha kategoritë e pronave, me përjashtim të kategorisë pronë publike, si vijon:

Kategoria e Pronës	Norma tatimore
Për njësitet bujqësore të parcelave	0.15 %
Për njësitet bujqësore të objekteve	0.15%
Për njësitet pyjore të parcelave	0.15 %
Për njësitet rezidenciale të parcelave	0.15 %
Për njësitet rezidenciale të objekteve	0.15%
Për njësitet komerciale të parcelave	0.15 %
Për njësitet komerciale të objekteve	0.25 %
Për njësitet industriale të parcelave	0.30 %
Për njësitet industriale të objekteve	0.30 %

Neni 2
Baza Tatimore - Zona dhe Nën zonat tatimore

Për vitin 2019 rikonfirmohet baza e njëjtë tatimore dhe ndarje e njëjtë e zonave dhe nën zonave tatimore sipas rregullores Nr. I - 75 e datë 18.09.2017 për Tatimin mbi Pronën e Paluajtshme për Komunen e Obiliqit.

Neni 3
Çdo dispozitë tjetër që nuk ceket në këtë vendim është e rregulluar me Ligjin Nr 06/L-005 për Tatimin i cili ka shfuqizuar Ligjin Nr; 03/L-204 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme .

Neni 4
Hyrja në fuqi
Ky vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në Web faqen Zyrtare të Komunës dhe do të fillojë të zbatuar nga 1 janari 2019.

Vendimi Nr. _____

Kryesusi i Kuvendit
Burim Gërguri